



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-30

PËR MBETURINA

Kuvendi i Kosovës

Në bazë të Rregullores 2001/9, datë 15 maj 2001, Mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme të Kosovës, veçanërisht Kreun 5.1., 5.7, 9.1.26 a, 9.3.2., e me qëllim të formimit të Kornizës ligjore për administrimin e mbeturinave në Kosovë dhe krijimit të mekanizmave dhe kushteve sipas standardeve Evropiane për administrimin e mbeturinave,

Miraton:

LIGJIN PËR MBETURINA

I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim:

Mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit nga ndotja dhe rreziku nga mbeturinat, përmes administrimit të mbeturinave, duke krijuar kushte për parandalimin dhe zvogëlimin e prodhimit të mbeturinave dhe rrezikshmërisë së tyre, veçanërisht përmes:

- a) zhvillimit të teknologjive të pastra dhe përdorimit efikas të tyre,
- b) zhvillimit dhe përdorimit të produkteve të cilat për nga natyra e prodhimtarisë dhe deponimit përfundimtar të tyre, janë të dizajnuara për uljen e dëmshmërisë së mbeturinave dhe rrezikshmërisë nga ndotja.
- c) zhvillimit të teknikave të duhura për deponimin përfundimtar të substancave të rrezikshme të cilat i përmbajnë mbeturinat me mundësi përpunimi.
- d) përpunimit të mbeturinave me anë të riciklimit, ripërdorimit apo të ndonjë procesi tjetër, për nxjerrjen e lëndëve sekondare.
- e) përdorimit të mbeturinave si burim i energjisë; dhe
- f) sanimit të vendeve të ndotura nga mbeturinat.

Neni 2 Lënda e rregullimit

Ky ligj:

2.1. Rregullon të drejtat dhe detyrimet e personave fizik dhe juridik, të cilët bëjnë administrimin e mbeturinave.

2.2. Rregullon përgjegjësitë dhe veprimtaritë e administrimit të mbeturinave, duke përfshirë identifikimin, klasifikimin, planifikimin, organizimin dhe përcaktimin e kushteve për veprimtaritë e administrimit të mbeturinave, lëshimin e liçensave për administrimin e mbeturinave dhe caktimin e kushteve të pranueshme mjedisore, për veprime me mbeturina.

2.3. Synon të sigurojë që administrimi i mbeturinave të bëhet në atë mënyrë që të minimalizohet rreziku për dëmtimin e shëndetit të njeriut dhe mjedisit, duke parandaluar:

- a) Ndotjen e ujërave, ajrit, tokës dhe rrezikun nga dëmtimet e biodiversitetit;
- b) Aromat e dëmshme dhe kundërmimet, parazitët dhe bezdisjet tjera;
- c) Rrezikun nga eksplodimet dhe zjarri;
- d) Ndikimet negative në objektet dhe vendet me rëndësi të veçantë, siç janë zonat e mbrojtura të parapara me ligj.

Neni 3

Dispozitat e këtij ligji nuk vlejné për:

- a) mbeturinat dhe materiet radioaktive;
- b) emisionet në atmosferë;
- c) trajtimin dhe shkarkimin e efluentëve në ujëra, përveç trajtimin e efluentit në/ose të shkarkuar nga objekti për ruajtje, përpunim, trajtim ose deponim të mbeturinave;
- d) ujërat e ndotura dhe efluentet nga kanalizimi, përveç, llumit nga objektet për trajtimin e ujërave të kanalizimit;
- e) eksplozivët.

Neni 4 Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë ligj nënkuptojné:

Mbeturinë - çdo substancë ose lëndë e specifikuar në (Shtojcën 01. të këtij ligji) të cilën zotëruesi e hedh, mendon ta hedh ose është i detyruar ta hedh.

Administrim i mbeturinave - nënkupton grumbullimin, mbledhjen, ndërmjetësimin, shitblerjen, manipulimin, transportimin, përpunimin, trajtimin dhe deponimin e mbeturinave, duke përfshi edhe mbikëqyrjen e operacioneve të tilla si dhe përkujdesjen pas mbylljes së deponive.

Hedhurinë - pjesë e mbeturinës, lëndë ose substancë e cila mbetet pas përpunimit të mbeturinës, komponente ose elemente të cilat nuk kanë vlerë përdorimi.

Kompostimi - është proces i kontrolluar biologjik, për zbërthimin e mbeturinave organike, nën veprimin e mikroorganizmave në prezencën e oksigjenit i cili kryhet me qëllim të prodhimit të kompostit.

Liçensa për administrimin e mbeturinave - është dokument mjedisor që lëshohet nga autoriteti kompetent, me të cilin dëshmohet se përmbushen kushtet për administrimin e mbeturinave.

Person - nënkuptohet çdo person fizik ose juridik i cili është i involvuar në mënyrë direkte apo indirekte, në proceset për administrimin e mbeturinave.

Personi i duhur - për qëllim të këtij ligji personi është i duhur, nëse:

- a. nuk ka kryer vepër penale;
- b. ka resurse adekuate financiare të përmbushë detyrat e tij; dhe
- c. ka përvojë dhe përgatitje profesionale të domosdoshme, për realizimin e detyrave të tij.

Trajtimi i mbeturinave - nënkupton procesin fizik, kimik, biologjik, termal, duke përfshi edhe ndarjen e mbeturinave në lloje, me qëllim të pakësimit të vëllimit dhe karakteristikave të dëmshme të mbeturinave, si dhe lehtësimin për manipulim me mbeturina ose riciklimin e tyre.

Riciklim - nënkuptohet procesi për trajtimin dhe ripërdorimin e plotë ose të pjesërishtë të mbeturinave.

Prodhues i mbeturinave - çdo person, veprimtaria e të cili prodhon mbeturina ose/dhe i cili kryen para procesimin, përzierjen ose veprime të tjera që rezultojnë në ndryshimin ose përbërjen e mbeturinës.

Mbeturinat industriale - janë mbeturina të cilat prodhohen nga aktivitetet ose proceset industriale ose të prodhimit të artizanate dhe aktivitete tjera prodhuese.

Mbeturinë speciale - nënkuptohet mbeturina e cila për nga natyra e gjenerimit dhe trajtimit konsiderohet e veçantë. Sipas këtij ligji, mbeturinat speciale përfshijnë:

- a) bateritë dhe akumulatorët e shpenzuar;
- b) vajrat e përdorura;
- c) gomat e vjetra dhe të shpenzuara;
- d) mbeturinat nga ambalazhet dhe paketimet;
- e) mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike;
- f) gypat floroshent të cilët përbëjnë merkur;
- g) mbeturinat që përmbajnë PCB dhe PCT;
- h) mbeturinat që përbëjnë azbest;
- i) automjetet e hedhura dhe mbeturinat e tyre;
- j) mbeturinat nga demolimi dhe konstruktimi i objekteve ndërtimore;
- k) mbeturinat nga bujqësia dhe agroekonomia;

Përpunimi i mbeturinave - çdo operacion ose veprimtari që kryhet për qëllime riciklimi ose ripërdorimi të mbeturinave, pjesërisht ose në tërësi, duke përfshirë edhe çdo aktivitet të specifikuar në Shtojcën 03 (lista R dhe D), të këtij ligji.

Mbeturina komerciale - nënkuptohen mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren, vetëm apo kryesisht, për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshijn mbeturinat e komunalive dhe industriale.

Deponi - quhet vendi i caktuar (i rregulluar) i mbeturinave, nën apo mbi sipërfaqe të tokës, ku vendosen mbeturinat, duke përfshi:

- vendin e brendshëm ku vendosen mbeturinat (deponinë ku prodhuesi i mbeturinave e dërgon mbeturinën e vet për deponim, në vendin e prodhimit);
- vendin e përhershëm (më shumë se një vit) i cili përdoret për vendosjen e përkohshme të mbeturinave, por përjashtohen:
- objektet ku mbeturinat shkarkohen në mënyrë që të bëhet përgatitja e tyre për transport të mëtejshëm, me qëllim të përpunimit, trajtimit ose deponimit diku tjetër;
- vendet për ruajtje të mbeturinave, para përpunimit ose trajtimit për një periudhë më të shkurtër se tri vjeçare, ose
- vendet për ruajtje të mbeturinave para deponimit për periudhë deri në një vit.

Mbeturinat komunale - janë mbeturina nga amvisëritë, po ashtu edhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.

Operatori- është person fizik ose juridik i cili në përputhje me dispozitat e këtij ligji administron, kontrollon ose është përgjegjës për objektet dhe pajisjet e mbeturinave ose është i autorizuar të marrë vendime në lidhje me funksionet ekonomike ose teknike të pajimeve dhe objekteve.

Mbledhja e mbeturinave - është aktivitet sistematik i grumbullimit, klasifikimit dhe/ose përzierjes së mbeturinave, me qëllim të transportimit.

Mbeturinat të rrezikshme - janë mbeturinat që kanë së paku njërin nga këto karakteristika si vijon:

- eksplozive,
- oksiduese,
- të ndezshme,
- irituese,
- dëmtuese,
- toksike,
- kancerogjene,
- korrozive,
- infektuese,
- teratogjenike,
- mutagjenike,
- liron gazra toksike në kontakt me ujin, ajrin ose një acid,
- ka mundësi për prodhimin e substancave tjera të rrezikshme dhe
- ekotoksike.

Zotëruesi i mbeturinave - është prodhuesi i mbeturinës, personi fizik ose juridik, në pronësinë ose kontrollin e të cilit gjendet mbeturina.

Mbeturina të parrezikshme - janë mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme.

Mbeturina inerte - janë mbeturinat të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar. Mbeturinat inerte nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk biodegradojnë në kontakt me materiet tjera, nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Tërë eluati dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor.

Kullimi - çdo lëng që shpërlan mbeturinat e deponuara dhe që emitohet nga, ose gjendet brenda deponisë.

Deponim i mbeturinës - çdo veprimtari ose operacion i paraqitur në Shtojcën 03 - lista D, të këtij ligji.

Bezdisje - çdo ndërhyrje e rëndësishme me të drejtën e përdorimit të tokës, qoftë ajo me qëllim ose paqëllim e cila mund të shkaktojë lëndime, shqetësime ose dëmtime. Një ndërhyrje e tillë mund të përfshijë kundërmimet, parazitët, zhurmën, vibracionin ose shkarkimin e në ndonjë formë tjetër të ndotjes ose energjisë në mjedis.

Ndërmjetësues - nënkupton çdo person i cili në emër ose në shërbim të personit tjetër, organizon shitblerjen ose transferin nga një person në tjetrin për mbledhjen përpunimin ose deponimin e mbeturinës.

Shitblerës – nënkupton personin i cili shet ose blen mbeturina në emër të tij ose aranzhon në shërbim të ndonjë personi tjetër për blerje, shitje, bartje, mbledhje ose përpunim dhe deponim të mbeturinave.

Efluenti i ujërave të ndotura - nënkuptohen ujërat e ndotura që krijohen nga çdo veprim, aparaturë, pajisje ose gyp drenimi që përdoret për hedhjen e ujërave të ndotura, qofshin ato të trajtuara apo të pa trajtuara.

Pronar i mbeturinave - nënkupton personin fizik ose juridik i cili ka legjitimitetin mbi mbeturina dhe i cili ka të drejtë t'i përdorë mbeturinat sipas vullnetit të tij, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Autoritet publik - nënkuptohet pushteti qendror dhe lokal dhe institucionet tjera, të themeluar ose të autorizuar me ligj.

Ministria - nënkuptohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, (MMPH).

Magazinim - nënkuptohet ruajtja e sigurt dhe e përkohshme e mbeturinave.

Mbeturina të vëllimshme - janë mbetje me përmasa të mëdha pajisjesh dhe makinerish, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave bëhet në mënyrë të veçantë.

Qarkullim ndërkufitar - nënkupton lëvizjen legale të mbeturinave prej një shteti në shtetin tjetrin përmes kufijve ndërshtetëror.

Objekte dhe pajisje adekuate - quhen vendet dhe impiantet me instalime, vegla, mjete pune, ku në mënyrë të përshtatshme trajtohen, ruhen dhe deponohen mbeturinat.

Ministri - ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Interpretim i përgjithshëm - çdo term që është i përdorur në këtë ligj dhe në direktivat e Këshillit Evropian, do ta ketë kuptimin që është dhënë me Direktivën e Këshillit Evropian, përveç nëse në mënyrë të qartë, interpretimi i tij përdoret në mënyrë tjetër.

Shkurtesat e përdorura kanë këtë domethënie:

ADR- Marrëveshja Evropiane mbi Transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme,

EU - Unioni Evropian,

MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,

BATNEEC –Tecnologjia më e mirë e mundshme pa harxhime të mëdha,
EEC- Komuniteti Ekonomik Evropian,
EC- Këshilli Evropian,
OECD – Organizata Ekonomike për Kooperim dhe Zhvillim
RID- Rregulloret që kanë të bëjnë me transportin ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme përmes hekurudhës,
PCB- Poliklorurbifenil,
PCT- Poliklorurtrefenile.

II. PARIMET THEMELORE UDHËZUESE

Neni 5

Parimet themelore për administrimin e mbeturinave

1. Parimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Projektimi dhe implementimi i një sistemi të synuar, për administrimin e mbeturinave, do të bëhet:

- a) Për të balancuar (harmonizuar) objektivat e administrimit të mbeturinave me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.
- b) Kur zhvillimi i qëndrueshëm, sa i përket administrimit të mbeturinave, ka për qëllim shfrytëzimin efikas të resurseve, zvogëlimin e sasisë së mbeturinave të prodhuara dhe alokimin e arsyeshëm të shpenzimeve të cilat mund të përballohen nga Qeveria dhe popullata e Kosovës.

2. Parimi i afërsisë dhe vetë trajtimit.

Qeveria do të marr masa të duhura për krijimin e rrjetit të integruar dhe adekuat, për instalimet për hudhje, duke marrë parasysh teknologjitë më të mira të mundshme që nuk kërkojnë shpenzime të mëdha (BATNEEC). Qëllimi i këtij rrjeti është të mundësojë vetë trajtimin e mbeturinave duke marr parasysh rrethanat gjeografike dhe nevojën për instalime të specializuara për lloje të veçanta të mbeturinave. Ky rrjet, gjithashtu duhet të mundësojë deponimin e mbeturinave në njërin nga instalimet e përshtatshme në vendin sa më të afërt, duke përdorur metoda dhe teknologji sa më të përshtatshme, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e mjedisit dhe shëndeti i njeriut në nivel të lartë.

3. Parimi i vigjilencës dhe parandalimit.

Kur është e nevojshme, autoriteti publik ndërmerr dhe inkurajon veprime parandaluese në administrimin e mbeturinave.

4. Parimi ndotësi paguan.

Ky parim korrespondon me parimin e paraqitur në Rekomandimin e Këshillit 75/436/EEC, për alokimin e kostos dhe veprimin nga autoriteti i publikut në çështjet mjedisore dhe kërkon, veçanërisht që:

- a) personi i cili zhvillon aktivitetet për administrimin e mbeturinave është i detyruar të bëjë kompensimin e plotë të shpenzimeve për pasojat dhe dëmet e shkaktuara,
- b) shpenzimet për krijimin, trajtimin dhe deponimin e mbeturinave, duhet llogaritur çmimin e prodhimit dhe shërbimit.

5. Parimi për administrimin e sistematizuar të mbeturinave sipas prioriteteve (hierarkisë).

Administrimi i mbeturinave do të bëhet sipas sistemit të prioriteteve i cili në praktikë, do të bëhet sipas kësaj radhitjeje:

- a) Parandalimin ose zvogëlimin e prodhimit të mbeturinave dhe karakteristikave të rrezikshme, duke përfshirë edhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave të prodhuara më parë, gjatë ciklit të prodhimit.
- b) Trajtimi i mbeturinave të bëhet me metoda që mundësojnë ripërdorimin e plotë ose të pjesshëm të mbeturinave.
- c) Riciklimin e mbeturinave.
- d) Shfrytëzimin i vlerave të dobishme të mbeturinave (përfshirë kompostim, shfrytëzimin e mbeturinave si burim energjie etj).
- e) Incenerim pa përfitim të energjisë (trajtimi termik),
- f) Deponimin e mbeturinave në deponi, pa shkaktuar ndikime të dëmshme në mjedis.

6. Parimi i përgjegjësisë së prodhuesit – zotëruesit.

Prodhuesit, shpërndarësit, shitësit, importuesit e mallrave që ndikojnë në shtimin e sasisë së mbeturinave, mbajnë përgjegjësi për mbeturinat e krijuara gjatë aktiviteteve të tyre. Prodhuesi mban përgjegjësi më të madhe për shkak se mund të ndikoj në cilësitë dhe ambalazhet e mallrave të prodhuara. Prodhuesi gjithashtu është i detyruar që të kujdeset për pakësimin e krijimit të sasisë së mbeturinave nga mallrat e prodhuara, të zhvillojë prodhimtarinë e mallrave të riciklueshëm dhe të krijojë tregun e produkteve të veta të riciklueshme dhe të ripërdorshme. Ky parim ndërlidhet me konceptet e “parimit të përgjegjësisë së zgjëruar të prodhuesit”, ku prodhuesi mban përgjegjësi për mbeturinat e krijuara në çdo fazë të ciklit jetësor të prodhimit, në veçanti për llojet prioritare të mbeturinave.

7. Parimi i sigurimit financiar.

Qeveria, detyron personat që ndërmarrin veprime për administrimin e mbeturinave, të bëjnë sigurimin adekuat ose të paraqesin një formë tjetër të sigurimit financiar, për t'i mbuluar detyrimet e mundshme.

8. Parimi për qasje të publikut në informata.

Në pajtim me parimet e përfshira në Konventën e Aarhus-it, të gjithë personat kanë të drejtë edhe nëse nuk janë palë e interesuar, të kenë qasje në çfarëdo informate që ka të bëjnë me aktivitetet e administrimit të mbeturinave.

9. Parimi i mbrojtjes së të drejtave në gjykatë.

Çdo person që ndjehet i dëmtuar ose konsideron se është bërë shkelje e ligjit, gjatë administrimit të mbeturinave, ka të drejtë të ngre padi në gjykatë, për të realizuar të drejtën e konsideruar të tij.

III. LLOJET - KLASIFIKIMI DHE KARAKTERIZIMI I MBETURINAVE

Neni 6 Llojet e mbeturinave

6.1. Llojet e mbeturinave sipas këtij ligji janë:

- a) Mbeturinat komunale,
- b) Mbeturinat komerciale,
- c) Mbeturinat industriale,

6.2. Mbeturinat e cekura në paragrafin 6.1 të këtij neni, varësisht nga ekspozimi i rrezikshmërisë janë:

- a) Mbeturinat inerte,
- b) Mbeturinat e parrezikshme,
- c) Mbeturinat e rrezikshme,

Neni 7 Klasifikimi dhe veçoritë e mbeturinave

7.1. Në këtë ligj mbeturinat klasifikohen sipas Katalogut Evropian të Mbeturinave, të paraqitur në Shtojcën 01 dhe sipas listës së OECD, Shtojca 02.

7.2. Veçoritë e mbeturinës përcaktohen për të gjitha llojet e mbeturinave përveç mbeturinave të komunalive nga amvisëria.

7.3. Sipas skemës së caktuar nga Direktiva e Këshillit 259/93 EEC, mbi mbikëqyrjen dhe kontrollin e transportit të mbeturinave, brenda dhe jashtë Unionit Evropian e cila është e bazuar në Konventën e Bazelit, bëhet përcaktimi i veçorive të mbeturinave të dedikuara për import, eksport apo kalim transit.

7.4. Ministri, me akt nënligjor, përcakton mënyrat, procedurat, metodat e përcaktimit të veçorive të mbeturinave si dhe formularin mbi veçoritë e tyre.

IV. DOKUMENTAT E PLANIFIKIMIT PËR ADMINISTRIMIN E MBETURINAVE

Neni 8

Dokumentet e planifikimit për administrimin e mbeturinave janë:

- Plani Strategjik i Kosovës për administrimin e mbeturinave.
- Plani lokal për administrimin e mbeturinave.
- Plani për objektet dhe pajisjet e administrimit të mbeturinave.
- Plani operativ i operatorëve për administrimin e mbeturinave.

Neni 9
Plani Strategjik i Kosovës për Administrimin e Mbeturinave

9.1. Për sigurimin e kushteve për administrimin e mbeturinave në Kosovë në bazë të parimeve të paraqitura në nenin 5 të këtij ligji, duhet të përpilohet Plani Strategjik i Kosovës për Administrimin e Mbeturinave (tani e tutje Plani Strategjik).

9.2. Plani Strategjik përmban:

- a) Vlerësimin e gjendjes ekzistuese të administrimit të mbeturinave;
- b) Qëllimet themelore dhe masat për administrimin e mbeturinave;
- c) Masat për administrimin me mbeturina të rrezikshme;
- d) Orientimet për përpunimin dhe trajtimin e mbeturinave në përputhje me parimet e mbrojtjes së mjedisit dhe parimet administrative;
- e) Orientimet për deponimin e mbeturinave;
- f) Orientimet për sigurimin e masave më të volitshme teknike, prodhuese dhe administruese për arritjen e qëllimeve për administrimin e mbeturinave.

9.3. Planin Strategjik e harton Ministria në bashkëpunim me ministritë dhe autoritetet tjera kompetente.

9.4. Planin Strategjik e miraton Qeveria e Kosovës për periudhë kohore dhjetë vjeçare.

9.5. Plani Strategjik rishqyrtohet së paku në pesë vjet.

Neni 10
Planet lokale për administrimin e mbeturinave

10.1. Planet lokale për administrimin e mbeturinave nxjerrën me qëllim të administrimit të mbeturinave. Planet hartohen nga autoritetet lokale, konform Planit Strategjik nga neni 8 i këtij ligji.

10.2. Sipas nevojës, Ministria, mund të kërkojë që dy ose më shumë komuna të hartojnë planin e përbashkët lokal për administrimin e mbeturinave në përputhje me Planin Strategjik.

10.3. Planet sipas paragrafit 10.1 dhe 10.2 të këtij neni, hartohen së paku për periudhën prej 5 vitesh dhe rishqyrtohen sipas nevojës. Komunat hartojnë planin lokal të administrimit të mbeturinave brenda një viti, nga data e aprovimit të Planit Strategjik.

10.4. Hartimi i planit sipas paragrafit 10.1 dhe 10.2 të këtij neni, duhet të përmbajë:

- a) Sasinë dhe llojet e mbeturinave që pritet të krijohen, origjinën e mbeturinave të cilat do të shfrytëzohen ose deponohen, sipas planit, në vendin e caktuar.
- b) Sasitë dhe llojet e mbeturinave që pritet të krijohen, origjinën e mbeturinave të cilat do të pranohen prej komunave tjera.
- c) Sasitë dhe llojet e mbeturinave që pritet të krijohen, origjinën e mbeturinave të cilat do të dërgohen në komunat tjera.
- d) Qëllimin që do të arrihet për rishfrytëzim ose riciklim të mbeturinave në territorin e përfshirë në plan.
- e) Sasinë e mbeturinave që do të deponohen për territorin e planifikuar.
- f) Programin për grumbullimin e mbeturinave të komunalive nga amvisëritë.
- g) Programin për grumbullimin dhe ndarjen e mbeturinave të rrezikshme nga mbeturinat e komunalive, respektivisht nga amvisëritë.

- h) Propozimet për ripërdorimin dhe riciklimin e komponentave të ndryshme nga mbeturinat komunale.
- i) Programin për zvogëlimin e sasisë së materialeve biodegraduese dhe ambalazheve në mbeturinat komunale.
- j) Programet për ngritjen e vetëdijesimit dhe arsimimit të publikut, lidhur me administrimin e mbeturinave.
- k) Përshkrimin e lokacioneve për pajisjet dhe objektet duke përfshirë edhe kërkesat e nevojshme teknike për projektimin e objekteve të reja.
- l) Vlerësimin dhe kalkulimin e shpenzimeve si dhe burimet e mjeteve financiare, për realizimin e aktiviteteve të planifikuara.
- m) Programet e veçanta për llojet speciale të mbeturinave.
- n) Masat për pengimin e lëvizjes apo bartjes së mbeturinave të cilat nuk janë përfshirë në plane.
- o) Paraqitjen e mundësive për bashkëpunim, ndërmjet dy e më tepër komunave.
- p) Ndonjë çështje tjetër relevante.

10.5. Hartimi i planit të përshkruar sipas paragrafit 10.4 të këtij neni, bëhet në bashkëpunim me përfaqësuesit e ofruesve të shërbimeve, të administrimit të mbeturinave, shoqatave të ndryshme ekonomike dhe përfaqësuesve nga organizatat joqeveritare si dhe institucionet profesionale.

Neni 11

Plani për objektet dhe pajisjet e administrimit të mbeturinave

11.1. Për objektet, vendet dhe pajisjet, për të cilat sipas Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, është e nevojshme Leja Ekologjike, nxjerrët Plani për administrimin e mbeturinave i cili përmban:

- a) dokumentacionin me shënimet për mbeturinat e prodhuara, shfrytëzuara dhe për mbeturinat që i deponon vet ndërmarrja (llojin, përbërjen dhe sasinë e mbeturinave);
- b) masat e zbatuara nga ndërmarrja, me qëllim të pakësimit të mbeturinave në procesin e punës, në veçanti pakësimin e mbeturinave të rrezikshme;
- c) ndarjen e mbeturinave, në veçanti mbeturinave të rrezikshme dhe mbeturinave që përsëri mund të përdorën, me qëllim të pakësimit të mbeturinave të cilat duhet deponuar;
- d) zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njerëzve;
- e) përshkrimin e mënyrave që përdoren për magazinim, trajtim dhe deponim të mbeturinave, dhe
- f) çdo çështje tjetër relevante.

11.2. Plani për administrimin e mbeturinave i bashkëngjitet kërkesës për marrjen e Lejes Ekologjike.

11.3. Ndërmarrja është e detyruar që planin për administrimin e mbeturinave ta rishqyrtojë në çdo pesë vjet.

Neni 12

Plani operativ i operatorëve për administrimin e mbeturinave

12.1. Për të gjithë operatorët, për të cilët është e nevojshme liçensa për administrimin e mbeturinave, nxjerrët Plani operativ për administrimin e mbeturinave.

12.2. Plani Operativ për administrimin e mbeturinave për objektet dhe pajisjet, përmban:

- a) përshkrimin e lokacionit dhe identifikimin e burimit të rrezikut (operacionet dhe metodat për administrimin e mbeturinave, llojet e lejuara të mbeturinave, orët e punës);
- b) përgatitjen teknike të objekteve dhe pajimeve për parandalimin dhe kontrollimin e ndotjes (sistemi i drenazhimit për ujërat e ndotura, sistemet për trajtimin e ujërave të ndotura, sistemin e pastrimit të gazrave nga objektet dhe pajimet etj.);
- c) infrastrukturën e lokacionit (instalimet e rrymës, ujit, rruga, sigurimi i lokacionit, rrethojat etj.);
- d) zhvillimin e punës në objekte dhe pajime (kontrollimin e mbetjeve nga proceset, kontrollin e rrjedhave potenciale, mbrojtjen e mbeturinave nga zjarri, pranimin e mbeturinave dhe zbatimin e procedurave për kontroll, marrjen e mostrave dhe analizimin e mbeturinave, sistemin për matjen e sasisë së mbeturinave, magazinimin e mbeturinave të rrezikshme, procesin e trajtimit të mbeturinave të rrezikshme-pajisjet, veglat dhe veprimet me to);
- e) kontrollimin, mbikëqyrjen dhe njoftimin (e përbërjes së mbeturinave, kontrollimin e emisioneve të gazrave, cilësinë e ujërave të ndotura, përcjelljen e kushteve klimatike - meteorologjike);
- f) administrimin dhe mbikëqyrjen e kushteve të punës në objekte dhe pajisje (kontrollimin dhe njoftimin për pluhurin dhe thërmirat e suspenduara, kundërmimet, zhurmën, kontrollimin e kafshëve dhe shpezëve, kontrollin e bartjes së mbeturinave nga personat e paautorizuar);
- g) dokumentacionin për lokacionin (dokumentacionin e nevojshëm, evidentimin e mbeturinave të rrezikshme etj.) dhe
- h) çdo çështje tjetër relevante.

12.3. Plani operativ për administrimin e mbeturinave për deponi, do të përmbajë:

- a) përshkrimin e lokacionit dhe identifikimin e burimeve të rrezikut (fazat operative për administrimin e mbeturinave, llojet e mbeturinave të lejuara për deponim, orët e punës, etj.).
- b) përgatitjen e lokacionit me pajisjet për parandalimin dhe kontrollimin e ndotjes (sistemin për drenazhimin e ujërave të ndotura, sistemin për zënien dhe trajtimin e ujërave të ndotura, sistemin për administrimin e gazrave të deponisë, sistemin e administrimit të ujërave sipërfaqësor, sistemin për realizimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e shtresës përfundimtare për mbulimin e mbeturinave dhe rehabilitimin e vendit);
- c) infrastrukturën e deponisë për mbeturina (rrethoja, rrjeti i ujit dhe rrymës, rrugët etj.);
- d) zhvillimin e punëve në lokacion (kontrollin e mbetjeve, kontrollin e eloteve të mundshme, mbrojtjen nga zjarri në deponi, pranimin e mbeturinave dhe procedurat për

kontroll, marrjen e mostrave dhe analiza e mbeturinave, sistemin për matjen e sasisë së mbeturinave, shkarkimin, shtrirjen dhe ngjeshjen e mbeturinave, mbulimin e përditshëm të mbeturinave, sipas nevojës);

- e) mbikëqyrjen e vazhdueshme, kontrollimin e ndotjes dhe njoftimin (kontrollimin e gazrave dhe gazrave specifike të deponisë, njoftimin për përbërjen e mbeturinave, kontrollimin dhe njoftimin për ujërat e ndotura dhe inçizimin e kushteve meteorologjike);
- f) administrimin dhe mbikëqyrjen e kushteve në deponi (kontrollimi, monitoringu dhe lajmërimi për pluhurin dhe thërmiat e suspenduara, kundërmimet, zhurmën, kafshët dhe shpezët që gravitojnë në deponi, kontrollimin e shkarkimit, shtresimit, kompaktimit dhe mbulimit të mbeturinave);
- g) dokumentacionin për lokacionin (dokumentet e nevojshme për evidentimin e mbeturinave) dhe
- h) çdo çështje tjetër relevante.

12.4. Planin operativ të operatorëve për administrimin e mbeturinave të cilët bëjnë administrimin e mbeturinave, duhet bashkangjitur kërkesës për marrjen e liçensës për administrimin e mbeturinave.

V. AUTORITETET PËR ADMINISTRIMIN E MBETURINAVE

Neni 13

Autoritetet për administrimin e mbeturinave

Autoritete kompetente për administrimin e mbeturinave janë:

- a) Ministria,
- b) Komunat.

Neni 14

Ministria kryen këto aktivitete:

- a) harton Planin Strategjik ;
- b) lëshon liçensat për administrimin e mbeturinave dhe mban evidencën në regjistra;
- c) aprovon planet lokale për administrimin e mbeturinave;
- d) krijon bazën e shënimeve dhe sistemin informativ për administrimin e mbeturinave;
- e) zbaton marrëveshjet ndërkombëtare për administrimin e mbeturinave;
- f) aprovon sistemin për mbulimin e shpenzimeve administrative, lidhur me administrimin e mbeturinave.

Neni 15

15.1. Komunat kanë për detyrë:

- a) të hartojnë planin lokal për administrimin e mbeturinave;
- b) të hartojnë raporte vjetore mbi administrimin e mbeturinave të cilat i dorëzojnë në Ministri, në tremujorin e parë të vitit vijues;

- c) të rregullojnë, zbatojnë dhe organizojnë administrimin e mbeturinave komunale në territorin e tyre;
- d) të marrin pjesë në lëshimin e vendimeve për ndërtimin e objekteve, për trajtimin e mbeturinave;
- e) të kryejnë punë tjera, të përshkruara me këtë ligj si dhe aktet tjera, për administrim të mbeturinave;
- f) të caktojnë tarifatat për shërbimet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale nga ndërmarrjet për administrimin e mbeturinave.

15.2. Dy apo më shumë komuna, për interesin e tyre, mund të bëjnë marrëveshje për administrimin e mbeturinave në territorin e tyre.

15.3. Përmes inspektorit komunal mjedisor, bëjnë mbikëqyrjen dhe kontrollin për administrimin e mbeturinave.

VI. PËRGJEGJËSITË DHE DETYRIMET PËR ADMINISTRIMIN E MBETURINAVE

Neni 16

Detyrat e përgjithshme të zotëruesit të mbeturinave

16.1. Personi i palicensuar nuk mund të zotëroj, transportoj, trajtoj, përpunoj, deponoj mbeturina të cilat shkaktojnë ose mund të shkaktojnë ndotje mjedisore.

16.2. Zotëruesi nuk mund të transferoj kontrollin e mbeturinave te çdo person tjetër, përveç tek personat e autorizuar me këtë ligj.

16.3. Zotëruesi i mbeturinave informon menjëherë autoritetin kompetent për çfarëdo humbje, shkapërderdhje, aksident, ndonjë zhvillim tjetër lidhur me mbeturinat të cilat shkaktojnë ose mund të shkaktojnë ndotje.

16.4. Ministri, me akt nënligjor, specifikon detyrat e veçanta për zotëruesin e mbeturinave, sipas këtij neni.

16.5. Zotëruesi i mbeturinave regjistrohet në Regjistrin për administrimin e mbeturinave, në harmoni me këtë ligj.

16.6. Zotëruesi i mbeturinave është përgjegjës për të gjitha shpenzimet e transportit, trajtimit dhe deponimit të mbeturinave, deri sa nuk ia dorëzon personit të autorizuar.

Neni 17

Detyrimet e prodhuesit dhe importuesit të mallrave

17.1. Në lidhje me prioritetet e llojeve të caktuara të mbeturinave, prodhuesi ose importuesi, mund të jetë përgjegjës për mbledhjen dhe deponimin e mbeturinave të prodhuara nga mallrat e tyre.

17.2. Ministri, me akt nënligjor, identifikon prioritetet e tilla për llojet e mbeturinave dhe t'i përcaktojë rregullat për mbledhjen dhe deponimin e këtyre mbeturinave.

Neni 18

Detyrimet e prodhuesve të mbeturinave

Detyrimet e prodhuesve të mbeturinave janë:

- a) hartimi dhe implementimi i planeve operative për administrimin e mbeturinave, të parapara me nenin 11 dhe 12 të këtij ligji;
- b) pajisja me dokumentacionin përkatës për përcaktimin e veçorive të mbeturinave nga laboratorit i autorizuar dhe dokumentin për klasifikimin e mbeturinave nga Ministria;
- c) mbledhja dhe klasifikimi i mbeturinave, varësisht nga trajtimi që do t'iu bëhet atyre;
- d) ruajtja e sigurt e mbeturinave, duke përdorur masat parandaluese për zvogëlimin ose parandalimin e ndikimeve negative në mjedis dhe shëndetin e njeriut;
- e) dorëzimi i mbeturinave personave të autorizuar me këtë ligj, për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave;
- f) mbajtja e regjistrit për administrimin e mbeturinave të cilat krijohen, dorëzohen, trajtohen ose deponohen;
- g) lejimi i qasjes së lirë organit kompetent të kontrollojë dhe mbikëqyrë lokacionin, objektet, impiantet, instalimet e tyre, dhe inspektimi i dokumentacionit për administrimin e mbeturinave.

Neni 19

Detyrimet e transportuesit të mbeturinave

Personat e autorizuar për transportimin e mbeturinave, kanë për detyrë:

- a) të bëjnë transportimin e mbeturinave, në harmoni me kushtet e përshkruara me licensën, për transportimin e mbeturinave;
- b) t'i mundësojë organit kompetent qasje të lirë, për kryerjen e mbikëqyrjes dhe kontrollimit të automjetit, barrës së ngarkuar dhe dokumentacionit përcjellës;
- c) të mbajë regjistrin për çdo transport të mbeturinave dhe të ofrojë informata lidhur me transportin e mbeturinave të rrezikshme sipas dispozitave të këtij ligji dhe akteve tjera normative, për mbeturina të rrezikshme dhe mbeturina speciale.

Neni 20

Detyrimet e operatorit për trajtimin e mbeturinave

Operatori që bënë trajtimin e mbeturinave përmbush këto detyrime:

- a) harton planin operativ për administrimin e mbeturinave për pajisje, siç parashihet me nenin 11 dhe 12, të këtij ligji dhe siguron zbatimin e tij;
- b) kryen aktivitetet për trajtimin e mbeturinave në përputhje me kushtet e paraqitura në licensë;
- c) administron impiantet, instalimet dhe aparaturat për trajtimin e mbeturinave, në harmoni me udhëzimet dhe standardet teknike përkatëse;
- d) mban regjistrat dhe ruan shënimet për mbeturinat, në harmoni me rregullat e përshkruara në këtë ligj;
- e) lejon qasje të lirë organit kompetent të kontrollojë dhe mbikëqyrë lokacionin, objektet, impiantet, instalimet e tyre dhe inspekton dokumentacionin për administrim të mbeturinave dhe
- f) në rast aksidenti, menjëherë njofton organin kompetent, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 21
Detyrimet e operatorit në deponi

21.1. Operatori i deponisë përmbush këto detyrime:

- a) harton planin operativ për administrimin e mbeturinave në deponi dhe siguron implementimin e tij;
- b) deponon mbeturinat, në pajtim me kushtet e parapara me licensë;
- c) zbaton masat të cilat garantojnë mbrojtjen e mjedisit, në harmoni me kërkesat e përcaktuara me dispozitat në fuqi;
- d) lejon qasje të lirë organit kompetent të kontrollojë dhe mbikëqyrë deponinë dhe inspekton dokumentacionin e deponisë;
- e) mban regjistrat, sipas dispozitave të këtij ligji dhe
- f) në rast aksidenti, menjëherë njofton autoritet kompetente të parapara me këtë ligj dhe aktet nënligjore.

21.2. Operatori i deponisë është i detyruar të refuzoj pranimin e mbeturinave të cilat nuk mund t'i deponoj, sipas kushteve të licensës së tij.

VII. AKTIVITETET PËR ADMINISTRIMIN E MBETURINAVE

Neni 22

Ngritja e objekteve dhe pajisjeve për administrimin e mbeturinave

22.1. Objektet dhe pajisjet për administrimin e mbeturinave, duhet të jenë të lejuara dhe teknikisht të përgatitura për trajtimin, magazinimin, dhe deponimin e mbeturinave.

22.2. Ndërtimi dhe funksionimi i objekteve dhe pajisjeve për administrimin e mbeturinave, duhet të jetë në përputhje me ligj.

22.3. Një apo më shumë komuna, në marrëveshje në mes tyre, mund të caktojnë dhe shfrytëzojnë lokacionin në territorin e tyre, për ndërtimin e objekteve si në paragrafin 1 të këtij neni.

22.4. Në qoftë se komunat nuk mund të arrijnë marrëveshjen mes tyre, për caktimin e lokacionit për administrimin e mbeturinave, vendimin përfundimtar për këtë çështje e merr Ministria.

Neni 23

Mbledhja dhe transportimi i mbeturinave

23.1. Personi i licensuar për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave, mbledh mbeturinën prej prodhuesit dhe/apo zotëruesit dhe atë e transporton deri tek objekti në të cilin bëhet administrimi i mbeturinave.

23.2. Mbeturinat e rrezikshme grumbullohen dhe transportohen si të veçuara.

23.3. Mbeturinat transportohen me mjete adekuate dhe mënyra të përshtatshme, për të mos ardhur deri tek shkapërderdhja, rrjedhja dhe rënia e tyre.

23.4. Nëse ndodh ndotja gjatë transportimit të mbeturinave, transportuesi është i detyruar që vendin e ndotur ta kthejë në gjendje të mëparshme.

23.5. Nëse mbeturina e transportuar, nuk pranohet në vendin e destinuar, transportuesi e kthen në vendin e pranimit.

Neni 24
Magazinimi i mbeturinave

24.1. Mbeturinat magazinohen në vende teknikisht të përgatitura për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave.

24.2. Afati për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave nuk mund të jetë më i gjatë se tre vite.

Neni 25
Trajtimi i mbeturinave

25.1. Trajtimi i mbeturinave bëhet në përputhje me kushtet për liçensim.

25.2. Trajtimi biologjik dhe termik lejohet, vetëm kur mbeturina përdoret si lëndë e parë sekondare, për përfitimin e energjisë.

Neni 26
Ripërdorimi dhe përpunimi i mbeturinave

26.1. Mbeturinat shfrytëzohen në cilësinë e lëndës së parë sekondare dhe për përfitimin e energjisë.

26.2. Mbeturinat që shfrytëzohen si lëndë e parë sekondare, mblidhen, transportohen dhe magazinohen si të veçanta.

26.3. Produktet e përfituara gjatë riciklimit të mbeturinave, duhet të mos shkaktojnë ndikime negative në mjedis.

26.4. Mbeturinat që mund të ripërdoren dhe riciklohen, nuk mund të deponohen ose digjen, pa lejen e Ministrisë.

Neni 27
Deponimi i mbeturinave

27.1. Mbeturinat, pasi që të jenë trajtuar dhe shfrytëzuar më parë, deponohen në objektet e liçensuara.

27.2. Deponitë e mbeturinave ndahen në:

- a) deponi e mbeturinave të rrezikshme;
- b) deponi e mbeturinave jo të rrezikshme dhe
- c) deponi e mbeturinave inerte.

27.3. Kushtet e liçensimit të deponive, përmbajtja e liçensës, procedura e pranimit të mbeturinave, mënyra e kontrollit të aktivitetit, monitorimi në fazën operuese, procedura e mbylljes dhe kujdesi pas mbylljes së deponive, përcaktohen me akt nënligjor për administrimin e deponive të cilin me propozimin e Ministrisë e nxjerr Qeveria.

27.4. Kriteret për zgjedhjen e lokacionit të deponive, sipas paragrafit 27.2 të këtij neni, me propozim të Ministrisë, me akt nënligjor i përcakton Qeveria.

Neni 28

Rregullat për administrimin e mbeturinave komunale

- 28.1. Mbeturinat komunale grumbullohen dhe trajtohen në përputhje me rregullat e këtij ligji dhe aktet tjera, për rregullimin e veprimtarive komunale.
- 28.2. Mbeturinat komunale të cilat janë të përziera me mbeturina të rrezikshme, duhet të veçohen nëse ekziston llogaria ekonomike, për ndryshe ajo mbeturinë si e përzier konsiderohet e rrezikshme.
- 28.3. Amvisëritë janë të detyruara që mbeturinat e tyre t'i hudhin në vend të caktuar të cilat i siguron ndërmarrja e licensuar për grumbullimin e mbeturinave, ndërsa mbeturinat e rrezikshme, dorëzohen në vendet e caktuara për to.
- 28.4. Komunat janë të detyruara të organizojnë grumbullimin e mbeturinave komunale të cilat nuk mund të hudhen në kontejner (mbeturinat e vëllimshme).
- 28.5. Amvisëritë dhe prodhuesit tjerë të mbeturinave komunale, janë të detyruar të bëjnë veçimin, me qëllim të riciklimit të tyre.
- 28.6. Komunat rregullojnë organizimin dhe mënyrën e veçimit të mbeturinave për riciklim, në përputhje me planin lokal, sipas paragrafit 1, të nenit 10 të këtij Ligji.

Neni 29

Rregullat e veçanta për administrimin e mbeturinave të rrezikshme

- 29.1. Mbeturinat e rrezikshme ndahen në bazë të karakteristikave të cilat e bëjnë mbeturinën të rrezikshme, në përputhje me listën H, C dhe Tabelën 1 në Shtojcën 03, të këtij ligji.
- 29.2. Gjatë grumbullimit, ndarjes apo selektimit, magazinimit, transportimit, trajtimit dhe deponimit të mbeturinave të rrezikshme, ambalazhohen dhe pakëtohen sipas rregullave të përcaktuara me aktin nënligjor të cilin me propozim të Ministrisë e nxjerr Qeveria.
- 29.3. Ndalohet deponimi i mbeturinave të rrezikshme, pa u bërë trajtimi paraprak, për t'i ulur komponentët e dëmshme në mbeturinë, zvogëlimin e cilësisë së rrezikshme dhe zvogëlimin e masës vëllimore të mbeturinave.
- 29.4. Është i ndaluar hollimi i mbeturinave të rrezikshme, me qëllim të shkarkimit të tyre në mjedis, përveç kur lejohet nga Ministria.
- 29.5. Ministri, me akt nënligjor, përcakton vlerat kufitare të përqendrimeve për komponentët e rrezikshme në mbeturina.

Neni 30

Dokumentet përcjellëse për bartjen e mbeturinave

- 30.1. Lëvizja prej një vendi në vendin tjetër e të gjitha mbeturinave, përveç atyre komunale nga amvisëritë, përcillet me dokumentacion të veçantë, gjithnjë deri sa të arrijnë në vend-destinacionin e caktuar.
- 30.2. Prodhuesi apo zotëruesi i mbeturinave, duhet ruajtur një kopje të dokumentacionit përcjellës të mbeturinave dhe dokumentin e plotësuar me shënime nga pranuesi i mbeturinave.

30.3. Kur prodhuesi apo zotëruesi i mbeturinave, në afat prej 30 ditësh nuk e pranon dokumentin e plotësuar nga pranuesi i mbeturinave, është i detyruar të inicioj procedurën e verifikimit për qarkullimin e mbeturinave si dhe të njoftojë menjëherë autoritetin kompetent.

30.4. Prodhuesi apo zotëruesi i mbeturinave, është i detyruar ta ruajë dokumentin përcjellës për bartjen të mbeturinave, së paku 2 vjet.

30.5. Përmbajtja, forma dhe mënyra e plotësimit të dokumentit për përcjelljen e mbeturinave, përcaktohet në Shtojcën 04, të këtij ligji.

Neni 31

Dokumenti përcjellës i mbeturinave të rrezikshme

31.1. Bartja e mbeturinave të rrezikshme përcjellët me dokument të veçantë.

31.2. Përmbajtja, numri i kopjeve, procedura e pranimit dhe dorëzimit nga personat kompetent, rregullohet me dispozitat e aktit nënligjor për mbeturina të rrezikshme.

Neni 32

Administrimi i mbeturinave speciale

Ministri, me akte nënligjore, përcakton rregullat e posaçme për administrimin e mbeturinave speciale.

VIII. LIÇENSA PËR ADMINISTRIMIN E MBETURINAVE

Neni 33

Liçenca për administrimin e mbeturinave

33.1. Personi nuk mundet të ndërmarrë ndonjë aktivitet për administrimin e mbeturinave, pa siguruar liçensën për administrimin e mbeturinave.

33.2. Kriteret për lëshimin apo mos lëshimin e liçensës, duke përfshirë formën e kërkesës, përmbajtjen dhe kushtet e liçensës, procedurat e lëshimit, kushtet e refuzimit, afatin e vlefshmërisë, revokimin dhe ndryshimet për liçensën, përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria.

IX. QARKULLIMI NDËRKUFITAR I MBETURINAVE

Neni 34

Dispozitat e përgjithshme për qarkullimin ndërkufitar të mbeturinave

34.1. Qarkullimi ndërkufitar i mbeturinave bëhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, Rregullores së CE 259/93/EEC, Konventës së Bazelit dhe sipas rregullave të transportit rrugor (ADR), transportit hekurudhor (RID) dhe transportit ajror.

34.2. Mbeturinat për të cilat objektet për trajtimin dhe deponimin e tyre nuk ekzistojnë në Kosovë, atëherë ato mund të eksportohen.

34.3. Lejohet importimi i mbeturinave jo të rrezikshme në Kosovë, vetëm kur ekzistojnë objektet dhe pajisjet adekuate për trajtim dhe nëse lejohet nga Ministria.

34.4. Ndalohet importimi dhe tranzitimi i mbeturinave të rrezikshme, përveç kur lejohet nga Qeveria.

34.5. Leja për tranzitimin e mbeturinave jo të rrezikshme do të lëshohet nga Ministria.

34.6. Mbeturinat që tranzitohen nëpër Kosovë, nuk mund të qëndrojnë në territorin e saj më gjatë se njëzet e katër orë.

34.7. Parashtruesi i kërkesës për leje, për qarkullimin ndërkufitar të mbeturinave, prezanton garancionin financiar apo ndonjë formë tjetër të sigurimit.

34.8. Ministri, me akt nënligjor, përcakton procedurën më të hollësishme të lëshimit të lejes për importim, eksportim dhe tranzit të mbeturinave.

Neni 35

Qarkullimi kundërligjor i mbeturinave

Kur qarkullimi ndërkufitar është i kundërligjshëm, importuesi me shpenzime të veta detyrohet të siguroj kthimin e mbeturinës te eksportuesi, në afat prej 7 ditësh, nga dita e arritjes në Kosovë.

X. RAPORTI DHE REGJISTRI I TË DHËNAVE PËR ADMINISTRIMIN E MBETURINAVE

Neni 36

Raporti për administrimin e mbeturinave

36.1. Raporti për administrimin e mbeturinave në territorin e Kosovës, është pjesë përbërëse e Raportit për gjendjen e mjedisit.

36.2. Komunitetet raportojnë për realizimin e planit lokal për administrimin e mbeturinave.

36.3. Prodhuesi dhe zotëruesi i mbeturinave, përveç prodhuesit të mbeturinave komunale, është i detyruar të paraqesë raport vjetor Ministrisë.

36.4. Raporti nga paragrafi 36.1. i këtij neni, përmban të dhënat mbi:

- a) llojin, përbërjen, karakteristikat, sasinë, origjinën, ruajtjen, transportin, trajtimin, përpunimin dhe deponimin e mbeturinave si dhe mbeturinave të cilat pranohen në objektet dhe pajisjet për administrimin e mbeturinave;
- b) llojin, përbërjen, karakteristikat, sasinë, origjinën, ruajtjen, transportin dhe destinimin e lëndës së parë sekondare, të përfituar në objektet për administrimin e mbeturinave.

36.5. Shtojca 05 e këtij ligji, përmban Formularin për raportin nga paragrafi 36.3 të këtij neni.

Neni 37
Regjistri i të dhënave

37.1. Regjistri i të dhënave përmban shënimet për llojin, karakteristikat, sasinë dhe klasifikimin e mbeturinave, objekteve dhe liçensave për administrimin e mbeturinave, lejeve për objektet për administrimin e mbeturinave, lejes për transportimin, importimin, eksportimin dhe tranzitin e mbeturinave.

37.2. Regjistrin e të dhënave për mbeturina e nxjerr dhe e mban Ministria.

XI. FINANCIMI PËR ADMINISTRIMIN E MBETURINAVE

Neni 38
Burimet për financim

38.1. Mjetet për financimin e administrimit të mbeturinave sigurohen nga:

- a) buxheti i Kosovës;
- b) buxheti komunal;
- c) donacionet dhe grantet;
- d) burimet nga pagesat e operatorëve, prodhuesve, zotëruesve dhe personave tjerë, sipas dispozitave të këtij ligji;
- e) burimet tjera financiare të përcaktuara me ligj.

38.2. Për administrimin e mbeturinave mund të përdoren edhe instrumentet ekonomike.

Neni 39
Shfrytëzimi i mjeteve financiare

Mjetet nga burimet financiare, sipas nenit 38 të këtij ligji shfrytëzohen, si vijon:

- a) për avancimin zhvillimor të organizatave për administrimin e mbeturinave;
- b) për implementimin dhe selektimin e mbeturinave pas mbledhjes së tyre;
- c) për stimulimin e procesit të riciklimit dhe themelimin e berzës së mbeturinave;
- d) për stimulim në zhvillimin dhe përdorimin e teknologjive të pastra, për trajtimin e mbeturinave;
- e) për shpenzime investive dhe operative për grumbullimin dhe trajtimin ose ripërdorimin e disa mbeturinave specifike dhe të shfrytëzueshme;
- f) për sanimin e vendeve të kontaminuara dhe ndotura në kohën e kaluar;
- g) për shpenzime të tjera, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe akteve tjera normative që rregullojnë mbrojtjen e mjedisit.

XII. MBIKËQYRJA ADMINISTRATIVE DHE INSPEKTUESE

Neni 40
Mbikëqyrja administrative

40.1. Mbikëqyrjen administrative, në zbatimin e këtij Ligji dhe dispozitave të nxjerra në bazë të këtij, e bënë Ministria.

40.2. Nëse gjatë mbikëqyrjes administrative, vërtetohet se vendimi i organit të mbikëqyrur i cili është i plotfuqishëm në procedurën administrative, është në kundërshtim me dispozitat materiale të këtij Ligji ose dispozitave të nxjerra në bazë të këtij Ligji, atëherë ai vendim shfuqizohet nga Ministria, sipas detyrës zyrtare.

40.3. Nëse gjatë mbikëqyrjes administrative vërtetohet, se vendimi i inspektorit të mjedisit i cili është i plotfuqishëm në procedurën administrative, është në kundërshtim me dispozitat materiale të këtij Ligji ose dispozitat e nxjerra në bazë të këtij ligji, atëherë ai vendim shfuqizohet nga Ministria, sipas detyrës zyrtare.

40.4. Vendimi mbi shfuqizimin, sipas paragrafit 40.1. dhe 40.2. të këtij neni, mund të merret në afatin prej një viti, nga dita e plotfuqishmërisë së tij.

40.5. Kundër vendimit nga paragrafi 40.4. i këtij neni, nuk është e lejuar ankesa, por mund të iniciohet kontesti administrativ.

Neni 41 Mbikëqyrja inspektuese

41.1. Inspektimin e aktiviteteve për administrimin e mbeturinave e bënë Inspektorati për mbrojtjen e mjedisit.

41.2. Me autorizim të Ministrit, inspektimin e aktiviteteve për administrimin e mbeturinave, mund ta bëjnë edhe zyrtarë të tjerë të Ministrisë.

Neni 42 Detyrat e inspektorit

Detyrat e inspektorit janë:

- a) kontrollimi për krijimin, prodhimin, mbledhjen, grumbullimin, ruajtjen, bartjen, trajtimin dhe deponimin e mbeturinave;
- b) Verifikimi i funksionimit të objekteve, pajisjeve dhe instalimeve, për trajtimin e mbeturinave;
- c) kontrollimi i transportit dhe lëvizjes së mbeturinave të rrezikshme brenda proceseve për administrimin e mbeturinave;
- d) verifikimi i administrimit të mbeturinave nga zotëruesi i mbeturinave;
- e) kontrollimi dhe konstatimi i realizimit të planeve, lidhur me administrimin e mbeturinave;
- f) kontrollimi i mënyrës së mbajtjes dhe ruajtjes së shënimeve për administrimin e mbeturinave;
- g) kontrollimi i mënyrës së procedimit, gjatë transportimit të mbeturinave brenda kufirit të Kosovës, gjatë tranzitimit, importimit dhe eksportimit;
- h) kontrollimi i zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe akteve të nxjerra në bazë të tij;
- i) hartimi i procesverbalit mbi inspektimet e bëra dhe jep propozime për masat e nevojshme, për administrimin e mbeturinave;
- j) konstatimi rreth plotësisë së kushteve për punë nga operatori, në përputhje me kushtet e përcaktuara me licensë, për administrimin e mbeturinave.

Neni 43
Autorizimet e inspektorit

Autorizimet e inspektorit janë:

- a) të urdhërojë realizimin e planit për administrimin e mbeturinave;
- b) të urdhërojë prodhuesin apo zotëruesin e mbeturinave të mbajë evidencë dhe t'i ruaj shënimet për mbeturinat siç është përcaktuar me këtë ligj dhe akte tjera;
- c) të urdhërojë prodhuesin apo zotëruesin e mbeturinave, t'ia dorëzojë mbeturinat vetëm personave juridik apo fizik të cilët janë të licënsuar për administrimin e mbeturinave;
- d) të urdhërojë prodhuesin për caktimin e personit përgjegjës për administrimin e mbeturinave;
- e) të urdhërojë zbatimin e masave me të cilat sigurohet mbrojtja e mjedisit, në objektet për administrimin e mbeturinave;
- f) të urdhërojë personat e licënsuar për administrimin e mbeturinave që të bëjnë grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave, të ndara në lloje;
- g) të ndalojë çdo transportim të barrës së ngarkuar me mbeturina i cili bëhet në kundërshtim me kushtet e përcaktuara me lejen për transportim dhe kërkesat që dalin nga Konventa e Bazel-it, ADR-së, RID dhe kriteret për transportin ajror;
- h) të ndalojë pranimin, trajtimin dhe deponimin e mbeturinave në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në licënsë;
- i) të ndalojë ndërtimin e objekteve dhe punën e impianteve dhe pajisjeve për administrimin e mbeturinave të cilat nuk i plotësojnë kushtet teknike dhe kërkesat tjera që dalin nga ky ligj dhe aktet tjera normative;
- j) të ndalojë transportimin e mbeturinave të rrezikshme, nëse transportuesi nuk posedon lejen dhe dokumentacionin e kompletuar;
- k) të ndalojë magazinimin e mbeturinave, në vendet të cilat teknikisht nuk janë të përgatitura për ruajtje të përkohshme të mbeturinave dhe nuk posedon apo i ka kaluar afati i vlefshmërisë së licënsës;
- l) të ndalojë përdorimin e objekteve, punën e pajisjeve, shfrytëzimin e aparaturave dhe veglave për të cilat nuk është lëshuar licënsa;
- m) të ndalojë punën e pajisjes mobile, për trajtimin e mbeturinave e cila nuk posedon leje për shfrytëzimin e lokacionit;
- n) të ndalojë përzierjen e mbeturinave komunale me mbeturinat e rrezikshme;
- o) të ndalojë pranimin e mbeturinave të rrezikshme në deponitë e mbeturinave komunale;
- p) të ndalojë përzierjen e llojeve të ndryshme të mbeturinave të rrezikshme;
- q) të ndalojë importimin, eksportimin dhe tranzitimin i cili bëhet në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe aktet tjera që dalin nga ky ligj.

Neni 44
Detyrat e inspektoratit komunal

Komunës i besohen punët e mbikëqyrjes inspektuese mbi veprimtaritë për administrimin e mbeturinave në ato objekte dhe pajisje, për të cilat lejen e ndërtimit e lëshon organi komunal, përveç mbikëqyrjes inspektuese në administrimin e mbeturinave të rrezikshme.

Neni 45

Vendimi dhe procedura e ankesës

45.1. Në procedurën e ushtrimit të mbikëqyrjes inspektuese mbi administrimin e mbeturinave, në rastet e marrjes së masave për urdhëresa dhe ndalesa, inspektori bie vendim.

45.2. Inspektori i mjedisit mund të bie vendim edhe verbal, nëse konsideron se kanoset rrezik i drejtpërdrejt, nga ndikimi i mbeturinave dhe palës i dërgohet vendimi me shkrim në afat prej 8 ditësh, nga dita e marrjes së vendimit verbal.

45.3. Kundër vendimit të inspektorit komunal për mbeturina, ankesa i drejtohet Kryeshefit ekzekutiv të komunës.

45.4. Në ankesën kundër vendimit të Kryeshefit ekzekutiv komunal dhe inspektorit mjedisor të Ministrisë, vendos Ministria.

45.5. Kundër vendimit të Ministrisë nuk është e lejuar ankesa, por mund të iniciohet kontesti administrativ.

Neni 46

Inspektori legjitimohet me dokument, formën dhe përmbajtjen e të cilit e përcakton ministri, me akt të veçantë.

XIII. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 47

47.1. Me gjobë prej 500 € deri 100.000 €, dënohet çdo person juridik po qe se bënë ndonjë të tjetër nga shkeljet si vijon:

- a). Kryerja e aktiviteteve për administrimin e mbeturinave, pa/ose/duke thyer kushtet e liçensës për administrimin e mbeturinave;
- b). Në bazë të paragrafit 2 nenit 16 të këtij ligji, personi i cili bart mbeturina të çfarëdo personi tjetër, përveç tek personi i autorizuar sipas këtij ligji;
- c). Zotëruesi i mbeturinave që nuk informon menjëherë autoritetin kompetent për çfarëdo humbje, shkapërderdhje, aksident, ndonjë zhvillim tjetër lidhur me mbeturinat të cilat shkaktojnë ose mund të shkaktojnë ndotje mjedisore, sipas paragrafit 3 nenit 16 të këtij ligji;
- d). Prodhuesi i mbeturinave i cili nuk harton dhe implementon, planin operativ për administrimin e mbeturinave, nuk e bënë ruajtjen e sigurt të tyre dhe nuk lejon qasje të lirë organit kompetent për mbikëqyrje, neni 18. par. 1. pika (a, d, dhe g);
- e). Nëse transportuesi i mbeturinave të rrezikshme bënë transportimin e mbeturinave në kundërshtim me liçensën, nuk mban dokumentacionin përkatës sipas këtij ligji dhe akteve tjera normative, neni 19 paragrafi 1. pika (a dhe c);

- f). Nëse operatori nuk harton planin operativ për administrimin e mbeturinave, nuk bën trajtimin e mbeturinave në përputhje me kushtet e liçensës dhe në rast aksidenti nuk njofton menjëherë organin kompetent, neni 20 paragrafi 1 pika (a,b dhe f);
- g). Nëse operatori në deponi, nuk harton planin operativ për administrimin e mbeturinave, nuk bën trajtimin e mbeturinave në përputhje me kushtet e liçensës dhe në rast aksidenti nuk njofton menjëherë organin kompetent, neni 21 paragrafi 1 pika (a,b dhe f);
- h). Paraqitësi i kërkesës i cili jep informata të pasakta ose të rrejshme, me qëllim të marrjes së liçensës;
- i). Importimi, eksporti ose tranzitimi i mbeturinës bëhet pa lejen e nevojshme ose duke i thyer kushtet e saj, ose duke shkel dispozitat e këtij ligji apo çfarëdo akti tjetër normativ.

47.2. Me gjobë prej 200 €deri në 5.000 €, dënohet edhe personi përgjegjës i personit juridik, për punët nga paragrafi 47.1 i këtij neni.

Neni 48

Përpos ndëshkimeve financiare të paraqitura në nenin 47, si masë preventive për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, nga inspektorati mund të urdhërohen edhe:

- a) kryerja e punëve të nevojshme nga operatori ose bartësi i liçensës,
- b) intervenimi i autoritetit kompetent në pronë, në mënyrë që të kryejë punët e nevojshme, me kompensimin e shpenzimeve nga operatori ose bartës i liçensës, ose
- c) konfiskimi i përkohshëm i pajisjeve.

Neni 49

49.1. Me gjobë prej 500 €deri 5.000 €, dënohet çdo person juridik po qe se bënë ndonjëren nga shkeljet si vijon:

- a) Shfrytëzon teknologjinë e cila nuk i plotëson kushtet për pakësimin e krijimit të mbeturinave dhe shfrytëzimin efikas të lëndëve të para (paragrafi 1, i nenit 17).
- b) Nuk siguron zbatimin e parimit të hierarkisë, nuk i grumbullon mbeturinat, të veçuara sipas llojeve, për nevojat e trajtimit të mëtutjeshëm dhe nuk i magazinon në kushte të sigurta, për të mos ndikuar në mjedis dhe shëndetin e njeriut (neni 18 pika c. dhe d.).
- c) Nuk e cakton personin e kualifikuar për punë profesionale në objektet dhe pajisjen për administrimin e mbeturinave (neni 21 pika g).
- d) Nuk i mban në rregull dhe nuk i ruan regjistrat me shënime të nevojshme (neni 18 pika f., neni 20 pika d. dhe neni 21 pika e.)
- e) Nëse bën transportin e mbeturinave në mjetin transportues të pambuluar apo mbyllur, ose mbeturinat nuk janë të paketuara dhe etiketuar në mënyrën e duhur dhe në rast se ndotja ndodh gjatë transportimit, nuk e bën pastrimin e vendit deri në shkallën e lejuar të ndotjes (neni 23 par. 2 dhe 3).

- f) Mban mbeturinat e magazinuara pas afatit të caktuar me ligj (neni 24 pika 2.).
- g) Bën deponimin e mbeturinave në kundërshtim me kushtet e liçensës (neni 27 paragrafi 1.).
- h) Nuk e bën grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme, ndaras prej mbeturinave komunale (neni 28 paragrafi 4).
- i) Nuk ndërmerr masa të veçanta për administrimin e mbeturinave speciale (neni 33).
- j) Nuk prezanton shënimet dhe raportet e nevojshme, në afatin e caktuar ligjor.

49.2. Me gjobë prej 100 € deri në 400 € dënohet edhe personi përgjegjës i personit juridik, për punët nga paragrafi 49.1 i këtij neni.

Neni 50

Me gjobë në shumë prej 100 € deri 400 € do të dënohet për kundërvajtje personi përgjegjës në organin e administratës, respektivisht organizata e cila bën autorizime publike, nëse:

- a) nuk e posedon planin për administrimin e mbeturinave;
- b) bën klasifikimin e mbeturinave pa nxjerrjen e çertifikatës për karakteristikat e mbeturinave;
- c) bën caktimin e karakteristikave të mbeturinave pa autorizim.
- d) jep pëlqime dhe lëshon leje sipas kërkesës, pa dokumentacion të kompletuar.
- e) nuk e bën lajmërimin e publikut.
- f) nuk ofron shënime nga baza e të dhënave për plotësimin e regjistrit të mbeturinave.
- g) nuk udhëheq dhe mban regjistrin qendror për mbeturina.

Neni 51

Ndëshkimet mandatore

Ministri do të nxjerr akt nënligjor, me të cilin rregullohen dhe sistemohen të gjitha veprimet me mbeturina që do të ishin të dëmshëm për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe të cilat do të ndëshkohen me gjoba mandatore.

Neni 52

Në rastet kur përgjegjësia nuk mund t'i imponohet, specifikisht një personi, ndërmarrjeje, grupi personash apo ndërmarrjesh, atëherë përgjegjëse do të jetë Qeveria e Kosovës, për përballimin e kostove që dalin nga eliminimi i mbeturinave të dëmshme ose riparimi i dëmit mjedisor, në pajtim me mundësit financiare.

XIV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 53 Zbatimi subsidiar

Për zbatimin e këtij Ligji dhe dispozitave që dalin nga ky ligj, do të zbatohen dispozitat e Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative, përveç kur përcaktohet ndryshe me këtë ligj.

Neni 54

Qeveria dhe Ministria, të gjitha aktet nënligjore që dalin nga ky ligj, do t'i nxjerrin në afat prej 18 muajsh.

Neni 55

Komunat janë të detyruara që në afat prej 18 muajsh, t'i harmonizojnë rregulloret e tyre, në bazë të këtij ligji.

Neni 56

Me miratimin e këtij ligj, shfuqizohet çdo dispozitë që rregullon këtë fushë dhe që është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 57

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji Nr. 02/L-30
22 korrik 2005

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik Nexhat Daci

SHTOJCAT

DOKUMENTET SHTOJCË NË LIGJIN PËR MBETURINA

Shtojcat e këtij ligji formojnë pjesën integrale të ligjit për mbeturina

Shtojcat kufizohen në çështje të standardeve shkencore, teknike, administrative.

Ndryshimet e standardeve në mënyrë automatike do të inkorporohen dhe ndryshohen pa procedura të rregullta ligjore.

Dokumentet përbërse të Ligjit për mbeturina janë të paraqitura si shtojcë e veçantë ku do të përfshihen:

Katallogu i BE për mbeturina, **Shtojca- 01**

Lista e mbeturinave sipas vendimit të Komisionit Europian No. **1999/816/EC** (Lista e gjelbërt, lista verdhë dhe lista e kuqe), **Shtojca -02**

Lista **H** dhe **C**, Lista **Q**, **D** dhe **R**, **Shtojca -03**

Dokumenti përcjellës gjatë bartjes së mbeturinave, **Shtojca - 04**

Formulari i Raportimit për mbeturina, **Shtojca- 05**

KATALLOGU I MBETURINAVE

Në bazë të vendimit 94/3/EC dhe 94/904/EC, kjo listë e mbeturinave hyn në fuqi më 01. Janar. 2002.

Katalogu i mbeturinave është një listë, në të cilën janë përfshirë të gjitha mbeturinat e rrezikshme, të pa rrezikshme dhe ato inerte dhe si i tillë lehtëson klasifikimin e të gjitha mbeturinave.

Grupet e mbeturinave janë të shenjzuar me numra dy-shifrorë, ndërsa emërtimi i llojit të mbeturinës është shenjzuar me numrin gjashtë-shifror.

Numrat për shenjzimin e mbeturinave quhen Kode të mbeturinave dhe kanë këto kuptime:

~ Dy numrat e parë tregojnë llojin e veprimtarisë apo aktivitetit ku është krijuar mbeturina.

~ Numri i tretë dhe i katërt, tregon procesin, në të cilin është prodhuar mbeturina.

~ Numri i pestë dhe i gjashtë tregon pjesën e procesit, në të cilin është krijuar mbeturina.

Klasifikimi i mbeturinave sipas katalogut Evropian të mbeturinave, në bazë të origjinës së mbeturinës ndahen në 20 – grupe, paraqitur në tabelën I:

Tab: I

NR.	GRUPET E MBETURINAVE
01	Mbeturinat që vijnë si rezultat i eksplorimit, mihjes, mveshjes si dhe përpunimeve tjera të mineraleve dhe minierave.
02	Mbeturinat nga agrokultura, hortikultura, gjuetia, peshkimi dhe prodhimet primare nga aquakultura, përgatitja dhe përpunimi i ushqimit.
03	Mbeturinat nga përpunimi i drurit, prodhimi i letrës, kartuçit, pulpës, panelit dhe mobileve.
04	Mbeturinat nga industritë e lëkurës, gëzofëve, tekstilit.
05	Mbeturinat nga rafinimi i naftës, purifikimi i naftës dhe trajtimi pirolitik i thëngjillit.
06	Mbeturinat nga proceset kimike inorganike.
07	Mbeturinat nga proceset kimike organike.
08	Mbeturinat nga prodhimi, formulimi, furnizimi dhe shfrytëzimi (PFFSh) i shtresave lyerëse (ngjyrave, verniqeve dhe emaeleve pa ngjyrë), ngjitësve, puthitësve dhe ngjyrave të shtypshkronjave.
09	Mbeturinat nga industria fotografike.
10	Mbeturinat inorganikenga proceset termale.
11	Mbeturinat inorganike që përmbajnë metal nga përpunimi i metaleve, mveshja e metaleve dhe hidrometalurgjia e metaleve të ngjyrosura.
12	Mbeturinat nga dhënia e formës dhe përpunimi sipërfaqësor i metaleve dhe plastikës.
13	Mbeturinat e vajrave (përpos vajrave ushqimore, 05 dhe 12).
14	Mbeturinat nga substancat organike që përdoren si tretës (përpos 07 dhe 08).
15	Mbeturinat nga paketimi i absorbuesve, leckave për fshirje, materialeve Filtruese dhe veshjeve mbrojtëse, të cilat nuk janë specifikuar ndryshe
16	Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe në listë.
17	Mbeturinat nga konstruktimi dhe demolimi në ndërtimtari (përfshirë edhe ndërtimin e rrugëve).
18	Mbeturinat nga shërbimet shëndetësore të njerëzve apo të kafshëve dhe/ apo hulumtimeve të tilla (me përjashtim të mbeturinave nga kuzhina dhe restorantet, të cilat nuk vijnë si rezultat i shërbimeve shëndetësore.
19	Mbeturinat nga pajisjet për përpunimin e mbeturinave, mbeturinat nga përpunimi i ujit të ndotur jashtë impiantit dhe industria e ujit.
20	Mbeturinat komunale dhe mbeturinat e ngjashme komerciale, industriale dhe ato institucionale përfshirë edhe fraksionet e mbledhura ndaras.

Katalogu Evropian i mbeturinave është i paraqitur në vazhdim:

01 MBETURINAT QË VIJNË SI REZULTAT I HULUMTIMIT, MIHJES, PASURIMIT DHE PËRPUNIMEVE TË TJERA TË MINERALEVE SI DHE NGA EKSPLOATIMI E THËRMIMI I GURIT

01 01 Mbeturinat nga mihja e mineraleve

01 01 01 Mbeturina nga mihjet e mineraleve metalmbajtëse

01 01 02 Mbeturina nga mihjet e mineraleve të jometaleve

01 02 Mbeturinat nga pasurimi i mineraleve

01 02 01 Mbeturinat nga pasurimi i mineraleve metalmbajtëse

01 02 02 Mbeturinat nga pasurimi i mineraleve jo-metalmbajtëse

01 03 Mbeturinat nga procesimet e mëtutjeshme fizike dhe kimike të mineraleve metalmbajtëse

01 03 01 Bëzhdilet (djerrina apo mbeturina)

01 03 02 Mbeturinat në formë të pluhurit dhe pudrës

01 03 03 Dheu i kuq nga prodhimi i aluminit

01 03 04* Mbeturinat nga përpunimi i mineraleve të cilat krijojnë acide

01 03 05* Mbeturinat tjera të cilat përmbajnë mbeturina të rrezikshme.

01 03 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

01 04 Mbeturinat nga procesimet e mëtutjeshme fizike dhe kimike të mineraleve jo metalmbajtëse

01 04 01 Mbeturina në formë zhavorri dhe gurët e thyer

01 04 02 Mbeturina në formë të rërës dhe argjilës

01 04 03 Mbeturina si në formë të pluhurit dhe puderës

01 04 04 Mbeturina nga potasa dhe procesimi i gurëve të kripës

01 04 05 Mbeturina nga pastrimi dhe larja e mineraleve

01 04 06 Mbeturina nga prerja dhe thyerja e gurëve

01 04 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

01 05 Balta nga rrëmihjet dhe mbeturinat tjera nga shpimet

01 05 01 Balta nga rrëmihjet që përmban vaj dhe mbeturina

01 05 02 Balta nga rrëmihjet që përmban barit dhe mbeturina

01 05 03 Balta nga rrëmihjet që përmban kloride dhe mbeturina

01 05 04 Balta nga shpuarjet në ujra të pastra dhe mbeturinat

01 05 05* Balta dhe mbeturinat nga shpimi, të cilat përmbajnë naftë

01 05 06* Balta nga shpimet dhe mbeturinat tjera nga shpimet që përmbajnë substance të rrezikshme

01 05 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

02 MBETURINAT NGA AGROKULTURA, HORTIKULTURA, GJUETIJA, PESHKIMI DHE PRODHIMET PRIMARE TË AKUAKULTURËS, PËRGATITJA DHE PËRPUNIMI I USHQIMIT

02 01 Mbeturinat e prodhimeve primare

02 01 01 Lluma nga larja dhe pastrimi

02 01 02 Mbeturinat e indeve të shtazëve

02 01 03 Mbeturinat nga bimët

- 02 01 04 Mbeturinat plastike (përpos nga paketimi)
- 02 01 05* Mbeturinat agrokemikale
- 02 01 06 Fekalet e shtazëve, urina dhe plehrat (përfshirë edhe kashtën e prishur), efluentet e mbledhura ndaras dhe të trajtuara jashtë atij vendi.
- 02 01 07 Mbeturina nga pylltaria.
- 02 01 08* Mbeturinat agrokimike dhe mbeturinat që përmbajnë substance të rrezikshme
- 02 01 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

- 02 02 Mbeturinat nga përgatitja dhe përpunimi i mishit, peshkut, dhe ushqimeve të tjera me origjinë të shtazëve**
- 02 02 01 Lluma nga larja dhe pastrimi
- 02 02 02 Mbeturina të indeve të shtazëve
- 02 02 03 Materiali jo i përshtatshëm për konsumim apo përpunim
- 02 02 04 Lluma nga vendet efluate të përpunimit.
- 02 02 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

- 02 03 Mbeturinat nga pemët, perimet, ushqimet e thata prej drithi, vajrat ushqimore, kakaos, kafes, prodhimit dhe procesimit të duhanit; procesimit të duhanit; prodhimet e konservave**
- 02 03 01 Lluma nga larja, pastrimi, rrjepja, centrifugimi dhe ndarja
- 02 03 02 Mbeturina nga agjentët për preservim
- 02 03 03 Mbeturina nga ekstraktimi i tretësit
- 02 03 04 Materiali jo i përshtatshëm për konsumim apo procesim
- 02 03 05 Lluma nga vendet efluate të përpunimit
- 02 03 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

- 02 04 Mbeturinat nga procesimi i sheqerit**
- 02 04 01 Dheu nga pastrimi dhe larja e rrepës
- 02 04 02 Kalcium karboniti i cili nuk është i specifikuar
- 02 04 03 Lluma nga vendet e efluate të përpunimit
- 02 04 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

- 02 05 Mbeturinat nga industrinë e prodhimeve të qumështit**
- 02 05 01 Materialet e papërshtatshme për konsumim apo procesim
- 02 05 02 Lluma nga vendet e efluate të përpunimit
- 02 05 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

- 02 06 Mbeturinat nga industria e ëmbëlsirave dhe pjekjet**
- 02 06 01 Materialet e papërshtatshme për konsumim apo procesim
- 02 06 02 Mbeturinat nga agjentët për perservim
- 02 06 03 Lluma nga vendet e derdhjes së përpunimit
- 02 06 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

- 02 07 Mbeturinat nga prodhimi i alkoolit dhe pijeve jo alkoolke (përpos kafes, çajit dhe kakaos)**
- 02 07 01 Mbeturinat nga larja, pastrimi dhe reduktimi mekanik i lëndës së parë
- 02 07 02 Mbeturina nga distilimi i spiritit
- 02 07 03 Mbeturina nga përpunimet kimike
- 02 07 04 Materialet e papërshtatshme për konsumim apo procesim
- 02 07 05 Lluma nga vendet e efluate të përpunimit
- 02 07 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

03 MBETURINAT NGA PËRPUNIMI I DRURIT DHE PRODHIMI I LETRËS, KARTONIT, PULPËS, PANELËS, DHE MOBILJEVE

03 01 Mbeturinat nga procesimi i drurit dhe prodhimit të paneleve dhe orendive

- 03 01 01 Mbeturinat si lëvozhga dhe tapa
- 03 01 02 Tallashi i sharrës
- 03 01 03 Sharritja, prerja, lënda e prishur e drurit/ copëtimet e dërrasës/ lustrimet
- 03 01 04* Byku i sharrës, pllakat iver (shumë shtresore), gdhenca të ndryshme dhe furnire që përmbajnë substance të rrezikshme.
- 03 01 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

03 02 Mbeturinat e preservatorëve (konzevansëve) të drurit

- 03 02 01* Prezervatorët organik jo-halogjenik të drurit
- 03 02 02* Prezervatorët organoklorinatë të drurit
- 03 02 03* Prezervatorët organometalik të drurit
- 03 02 04* Prezervatorët inorganic të drurit
- 03 02 05* Konzervansë të tjerë të cilët përmbajnë substanca të rrezikshme
- 03 02 99 Mbeturinat që nuk janë specifikuar ndryshe

03 03 Mbeturinat nga prodhimi dhe procesimi i pulpës, letrës dhe kartonit

- 03 03 01 Lëvozhgat
- 03 03 02 Fundërrina dhe llumi i lëngët ngjyrë të gjelbër (nga përpunimet me lëngje të zeza).
- 03 03 03 Llumi nga zbardhjet me proceset hiperklorite dhe klorite
- 03 03 04 Llumi nga zbardhjet dhe proceset tjera për zbardhje
- 03 03 05 Llumi i ngjyrës nga letra e ricikluar
- 03 03 06 Llumi i letrës dhe fijeve të saj
- 03 03 07 Tepricat e mbetura nga riciklimi i letrës dhe kartonit
- 03 03 08 Mbeturinat që ndahen nga letra dhe kartoni i ricikluar
- 03 03 09 Mbeturinat e lymit të gëlqerosur
- 03 03 10 Mbeturinat e fijeve lymrat e fijeve , mbushësve nga seperimi mekanik
- 03 03 11 Llumi nga trajtimi i ujërave të në vendin e ngjarjes
- 03 03 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

04 MBETURINAT NGA LËKURA, GËZOFI DHE INDUSTRITË E TEKSTILIT

04 01 Mbeturinat nga industria e lëkurës dhe gëzofit

- 04 01 01 Mbeturinat nga indet dhe ndarjet me gëlqere
- 04 01 02 Mbeturinat nga gëlqerja
- 04 01 03* Mbeturina nga heqja e yndyrëve që përmban tretës të cilët nuk kanë fazë të lëngët
- 04 01 04 Lëngu për ngjyrosje që përmban krom
- 04 01 05 Lëngu për ngjyrosje që nuk përmban krom
- 04 01 06 Lluma, posaçërisht nga vendi i përpunimit efluent që përmban krom
- 04 01 07 Lluma, posaçërisht nga vendi i përpunimit efluent që nuk përmban krom
- 04 01 08 Mbeturina e lëkurës së ngjyrosur (pëlhurat e kaltërta, gdhendja prerja, pluhuri për polirim)
- 04 01 09 Mbeturina nga mveshjet dhe procesi përfundimtar
- 04 01 99 Mbeturina të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

04 02 Mbeturinat nga industria e tekstilit

- 04 02 01 Mbeturina nga fijet e papërpunuara të tekstilit dhe substancave të tjera natyrale në formë të fijeve kryesisht me origjinë bimore
- 04 02 02 Mbeturina nga fijet e papërpunuara të tekstilit kryesisht me origjinë shtazore
- 04 02 03 Mbeturina nga fijet e papërpunuara të tekstilit kryesisht me origjinë artificiale apo sintetike
- 04 02 04 Mbeturina nga fijet e papërpunuara të përziera të tekstilit para tjerres dhe thurjes
- 04 02 05 Mbeturina nga fijet e përpunuara të tekstilit kryesisht me origjinë bimore
- 04 02 06 Mbeturina nga fijet e përpunuara të tekstilit kryesisht me origjinë shtazore
- 04 02 07 Mbeturina nga fijet e përpunuara kryesisht me origjinë artificiale apo sintetike
- 04 02 08 Mbeturina nga fijet e përziera të përpunuara të tekstilit
- 04 02 09 Mbeturina nga materialet e përziera (tekstili i impregnuar, elastomeri, plastomeri)
- 04 02 10 Lëndët organike nga produktet natyrale (p.sh. yndyra, parafina)
- 04 02 14* Mbeturina nga procesi përfundimtar që përmban tretës organik
- 04 02 15 Mbeturina tjera nga procesi përfundimtar të papërfshiera në 04 02 14
- 04 02 16* Lëndët për ngjyrosje dhe pigmentet që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 04 02 17 Lëndët për ngjyrosje dhe pigmentet tjera nga ato të paraqitura në 04 02 16
- 04 02 19* Lluma nga vendet efluente të përpunimit që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 04 02 20 Lluma nga vendet efluente të përpunimit nga ato të paraqitura në 04 02 19
- 04 02 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuar ndryshe

05 MBETURINAT NGA RAFINIMI I NAFTËS, PURIFIKIMI I GASIT NATYRAL DHE PËRPUNIMI PIROLIK I THËNGJILLIT

05 01 Llumat që përmbajnë vaj dhe mbeturinat e ngurta

- 05 01 02 Lluma nga shkripëzimi
- 05 01 03* Lluma nga fundërrina e rezervuarit
- 05 01 04* Lluma nga acidi alkilik
- 05 01 05* Derdhjet e vajrave
- 05 01 06 Lluma nga mirëmbajtja e mjeteve, aparaturave
- 05 01 07* Acidet e katranit
- 05 01 08* Katranet tjera
- 05 01 09* Lluma nga vendet e përpunimeve efluente që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 05 01 10 Lluma nga vendet tjera efluente të përpunimeve nga ato të paraqitura në 05 01 09
- 05 01 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuar ndryshe

05 02 Lluma pa përmbajtje të vajit dhe mbeturinat e ngurta

- 05 02 01 Lluma nga uji furnizues i bojlerit
- 05 02 02 Mbeturina nga shtyllat për ftohje
- 05 02 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuar ndryshe

05 04 Filterat e përdorur të argjirës

- 05 04 01* Filtrat e përdorur të argjirës

05 05 Mbeturinat e vajit për desulfurizim

- 05 05 01 Mbeturinat që përmbajnë sulfur
- 05 05 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuar ndryshe

05 06 Mbeturinat nga përpunimi pirolitik i thëngjillit

- 05 06 01* Acidet e katranit
- 05 06 02 Asfalti

- 05 06 03* Katranet tjera
- 05 06 04 Mbeturina nga shtyllat për ftohje
- 05 06 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

05 07 Mbeturinat nga purifikimi (pastrimi) i gasit natyrorë

- 05 07 01* Lluma që përmban merkur
- 05 07 02 Lluma që përmban sulfur
- 05 07 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

05 08 Mbeturinat nga regjenerimi i vajit

- 05 08 01* Filtrat e përdorur të argjilës
- 05 08 02* Acidet e katranit
- 05 08 03* Katranet tjera
- 05 08 04* Mbeturina ujore në formë të lëngut nga regjenerimi i vajit
- 05 08 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

06 MBETURINAT NGA PROCESET KIMIKE INORGANIKE

06 01 Mbeturina nga solucionet acidike

- 06 01 01* Acidi sulfurik dhe acidi sulfuror
- 06 01 02* Acidi hidroklorik
- 06 01 03* Acidi hidroflorik
- 06 01 04* Acidi fosforor dhe fosforik
- 06 01 05* Acidi nitrik and acidi nitror
- 06 01 99* Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

06 02 Mbeturina nga solucionet alkaline

- 06 02 01* Hidroksidi i kalciumit
- 06 02 02* Soda bikarboni
- 06 02 03* Amoniaku
- 06 02 99* Mbeturinat e kripërave dhe solucionet e tyre

06 03 Mbeturinat e kripërave dhe solucionet e tyre

- 06 03 01 Karbonatet (përveç 02 04 02)
- 06 03 02 Solucionet e kripërave që përmbajnë sulfate, sulfite dhe sulfur
- 06 03 03 Kripërat e ngurta që përmbajnë sulfate, sulfite dhe sulfur
- 06 03 04 Solucionet kripërore që përmbajnë kloride, fluoride dhe halide
- 06 03 05 Kripërat e ngurta që përmbajnë kloride, fluoride dhe kripërat e tjera të ngurta halogjenike
- 06 03 06 Solucionet kripërore që përmbajnë fosfate dhe kripëra të ngjashme të ngurta
- 06 03 07 Fosfatet dhe kripërat e ngjashme të ngurta
- 06 03 08 Solucionet kripërore që përmbajnë nitrate dhe komponime të ngjashme
- 06 03 09 Kripërat e ngurta që përmbajnë nitride (nitrometalike)
- 06 03 10 Kripërat e ngurta që përmbajnë amoniak
- 06 03 11* Kripërat dhe solucionet që përmbajnë cianide
- 06 03 12 Kripërat dhe solucionet që përmbajnë komponime organike
- 06 03 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

06 04 Mbeturinat që përmbajnë metal

- 06 04 01 Oksidet metalike
- 06 04 02* Kripërat metalike (përveç 06 03)
- 06 04 03* Mbeturina që përmban arsenik

- 06 04 04* Mbeturina që përmban merkur
- 06 04 05* Mbeturina që përmban metale të tjera të rënda
- 06 04 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

06 05 Lluma nga vendet efluente të përpunimit

- 06 05 02* Lluma nga vendet efluente të përpunimit që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 06 05 03 Lluma nga vendet tjera efluente të përpunimit nga ato të paraqitura në 06 05 02

06 06 Mbeturinat nga proceset kimike të sulfurit (prodhimi dhe transformimi) dhe proceset e desulfurizimit

- 06 06 01 Mbeturina që përmban sulfur
- 06 06 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

06 07 Mbeturinat nga proceset kimike halogjene

- 06 07 01* Mbeturinat që përmbajnë asbest nga elektroliza
- 06 07 02* Karboni i aktivizuar nga prodhimi i klorit
- 06 07 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

06 08 Mbeturina nga prodhimi i silikonit dhe derivative të silikonit

- 06 08 01 Mbeturina nga prodhimi i silikonit dhe derivative të silikonit

06 09 Mbeturinat nga proceset kimike të fosforit

- 06 09 01 Fosfogipsi
- 06 09 02 Zgjyra e cila përmban fosfor
- 06 09 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

06 10 Mbeturina nga proceset kimike të nitrogenit dhe prodhimi e plehrave

- 06 10 01 Mbeturina nga proceset kimike të nitrogenit dhe prodhimi i plehrave

06 11 Mbeturina nga prodhimi i pigmentve inorganike dhe ngjyrosësit

- 06 11 01 Gipsi nga prodhimi i dioksidit të titanit
- 06 11 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

06 13 Mbeturinat nga proceset tjera kimike inorganike

- 06 13 01* Pesticidet inorganike, biocidet dhe agjentët tjerë për gdhendjen e drurit
- 06 13 02* Karboni aktiv i harxhuar (përveç 06 07 02)
- 06 13 03 Bloza
- 06 13 04* Mbeturina nga procesimi i asbestit
- 06 13 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

07 MBETURINAT NGA PROCESET KIMIKE ORGANIKE

07 01 Mbeturinat nga Prodhimi, Formulimi, Furnizimi dhe shfrytëzimi i kemikaleve kryesore organike

- 07 01 01* Lëngjet ujore për larje dhe likuidet amë
- 07 01 03* Tretësit organik halogjenik, lëngjet për larje dhe likuidet amë
- 07 01 04* Tretësit tjerë, lëngjet për larje dhe likuidet amë
- 07 01 07* Fundërrina halogjenike dhe lluma nga reaksionet
- 07 01 08* Fundërrina të tjera dhe lluma nga reaksionet
- 07 01 09* Kallëpat e filterëve halogjenik, absorbuesit e harxhuar
- 07 01 10* Kallëpat e filterëve tjerë, absorbuesit e harxhuar
- 07 01 11* Lluma nga vendet efluente të përpunimit që përmban substanca të rrezikshme

07 01 12 Lluma nga vendet tjera efluente të përpunimit nga ato të paraqitura në 07 01 11
07 01 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

07 02 Mbeturinat nga PFFSh i plastikës, gomës sintetike dhe fijeve të krijuara nga njeriu

07 02 01* Lëngjet ujore për larje dhe likuidet amë
07 02 03* Tretësit organik halogjenik, lëngjet për larje dhe likuidet amë
07 02 04* Tretësit tjerë organik, lëngjet për larje dhe likuidet amë
07 02 07* Fundërrina halogjenike dhe lluma nga reaksionet
07 02 08* Fundërrina të tjera dhe lluma nga reaksionet
07 02 09* Kallëpat e filterëve halogjenik, absorbuesit e harxhuar
07 02 10* Kallëpat e filterëve tjerë, absorbuesit e harxhuar
07 02 11* Lluma nga vendet efluente të përpunimit që përmban substanca të rrezikshme
07 02 12 Lluma nga vendet tjera efluente të përpunimit nga ato të paraqitura në 07 02 11
07 02 13 Mbeturinat plastike
07 02 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

07 03 Mbeturinat nga PFFSh i ngjyrave organike dhe pigmenteve (përveç 06 11)

07 03 01* Lëngjet ujore për larje dhe likuidet amë
07 03 03* Tretësit organik halogjenik, lëngjet për larje dhe likuidet amë
07 03 04* Tretësit tjerë organik, lëngjet për larje dhe likuidet amë
07 03 07* Fundërrina halogjenike dhe lluma nga reaksionet
07 03 08* Fundërrina të tjera dhe lluma nga reaksionet
07 03 09* Kallëpat e filterëve halogjenik, absorbuesit e harxhuar
07 03 10* Kallëpat e filterëve tjerë, absorbuesit e harxhuar
07 03 11* Lluma nga vendet efluente të përpunimit që përmban substanca të rrezikshme
07 03 12 Lluma nga vendet tjera efluente të përpunimit nga ato të paraqitura në 07 03 11
07 03 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

07 04 Mbeturinat nga PFFSh i pesticideve organike (përveç 02 01 05)

07 04 01* Lëngjet ujore për larje dhe likuidet amë
07 04 03* Tretësit organik halogjenik, lëngjet për larje dhe likuidet amë
07 04 04* Tretësit tjerë organik, lëngjet për larje dhe likuidet amë
07 04 07* Fundërrina halogjenike dhe lluma nga reaksionet
07 04 08* Fundërrina të tjera dhe lluma nga reaksionet
07 04 09* Kallëpat e filterëve halogjenik, absorbuesit e harxhuar
07 04 10* Kallëpat e filterëve tjerë, absorbuesit e harxhuar
07 04 11* Lluma nga vendet efluente të përpunimit që përmban substanca të rrezikshme
07 04 12 Lluma nga vendet tjera efluente të përpunimit nga ato të paraqitura në 07 04 11
07 04 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

07 05 Mbeturinat nga PFFSh farmaceutikal

07 05 01* Lëngjet ujore për larje dhe likuidet amë
07 05 03* Tretësit organik halogjenik, lëngjet për larje dhe likuidet amë
07 05 04* Tretësit tjerë organik, lëngjet për larje dhe likuidet amë
07 05 07* Fundërrina halogjenike dhe lluma nga reaksionet
07 05 08* Fundërrina të tjera dhe lluma nga reaksionet
07 05 09* Kallëpat e filterëve halogjenik, absorbuesit e harxhuar
07 05 10* Kallëpat e filterëve tjerë, absorbuesit e harxhuar
07 05 11* Lluma nga vendet efluente të përpunimit që përmban substanca të rrezikshme
07 05 12 Lluma nga vendet tjera efluente të përpunimit nga ato të paraqitura në 07 05 11
07 05 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

07 06 Mbeturinat nga PFFSh i vajrave, yndyrëve, sapunëve, detergjentëve, disifinantëve dhe kozmetikës

- 07 06 01* Lëngjet ujore për larje dhe likuidet amë
- 07 06 03* Tretësit organik halogjenik, likuidet për larje dhe likerët amë
- 07 06 04* Tretësit tjerë organik, likuidet për larje dhe likerët amë
- 07 06 07* Fundërrina halogjenike dhe lluma nga reaksionet
- 07 06 08* Fundërrina të tjera dhe lluma nga reaksionet
- 07 06 09* Kallëpat e filterëve halogjenik, absorbuesit e harxhuar
- 07 06 10* Kallëpat e filterëve tjerë, absorbuesit e harxhuar
- 07 06 11* Lluma nga vendet efluente të përpunimit që përmban substanca të rrezikshme
- 07 06 12 Lluma nga vendet tjera efluente të përpunimit nga ato të paraqitura në 07 06 11
- 07 06 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

07 07 Mbeturinat nga PFFSh i kemikaleve specifike dhe produkteve kimike të cilat nuk janë specifikuar ndryshe

- 07 07 01* Lëngjet ujore për larje dhe likuidet amë
- 07 07 03* Tretësit organik halogjenik, lëngjet për larje dhe likuidet amë
- 07 07 04* Tretësit tjerë organik, lëngjet për larje dhe likuidet amë
- 07 07 07* Fundërrina halogjenike dhe lluma nga reaksionet
- 07 07 08* Fundërrina të tjera dhe lluma nga reaksionet
- 07 07 09* Kallëpat e filterëve halogjenik, absorbuesit e harxhuar
- 07 07 10* Kallëpat e filterëve tjerë, absorbuesit e harxhuar
- 07 07 11* Lluma nga vendet efluente të përpunimit që përmban substanca të rrezikshme
- 07 07 12 Lluma nga vendet tjera efluente të përpunimit nga ato të paraqitura në 07 07 11
- 07 07 99 Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe

08 MBETURINAT NGA PRODHIMI, FORMULIMI, FURNIZIMI DHE SHFRYTËZIMI (PFFSh) I SHTRËSAVE TË NGJYRËRAVE, LLAQEVE DHE EMALËVE QELQORE), NGJITËSVE, PUTHITËSVE DHE BOJAVE TË MAKINAVE PËR SHTYPJE

08 01 Mbeturinat nga PFFSH dhe and heqja e ngjyrëve dhe llaqeve

